



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonis, nr. 12-19) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit të dorëzuar nga parashtrues i panjohur, në seancën e 47-të të mbajtur me datë 31.03.2021 morri

VENDIM

NDËRPRITET procedura për lëndën e formuar pas denoncimit të dorëzuar nga parashtrues i panjohur, vulosur me numër të lëndës 12-5049/1 me datë 04.11.2019, në të cilën flitet për dyshime për paligjësi nga ana e Komunës së Shuto Orizares në procedurën për caktimin e statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje në parcelën kadastrës 1728/2 K.K.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të inetersave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndën me numër 12-5049/1 me datë 04.11.2019, me arsye se ka vepruar dhe ka ndërmarrë masa organ shtetëror kompetent.

Lënda me numër 12-5049/1 me datë 04.11.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e KSHPK në afat prej pesë ditë nga dita e vendimmarrjes.

SQARIM

Lënda me numër 12-5049/1 me datë 04.11.2019 është e formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtrues i panjohur.

Në denoncim flitet për dyshime për paligjësi të kryera nga ana e komunës së Shuto Orizares në procedurën për përcaktim të statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje në parcelën P.K. 1728 K.O. me tregun e Shuto Orizares është e vendosur kjo parcelë, deri në fundin e vitit 2016 ka menaxhuar personi juridik SHPTSH SHPK me pronarë dhe Sipas akuzave në denoncim, pas disa rasteve në vitet 2007/2008 në mënyrë joligjore me tregun ka menaxhuar, që në vitin 2008 ia ka shitur tregun personit Për tërë këtë periudhë në vendin e përmendur ka ekzistuar një objekt me karakter të përkohshëm i cili është blerë nga ana e personii cili pastaj e ka shfrytëzuar të drejtën e shfrytëzuesit për tokën ku është objekti, ka bërë transformim dhe ka fituar të drejtën e pronësisë. Pastaj, ka filluar procedurën për riformësim të parcelën ndërtimore dhe ka fituar të drejtën e pronës së tokës ku gjendet tregu. Ashtu siç është theksuar në denoncim, personi ka dorëzuar kërkesë për përcaktim të statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje e vulosur me numër 09-815/1 me

datē 23.05.2011 pēr objektet tē cilēt gjenden nē P.K. 1728 K.K. dhe nē procedurēn janē kryer mē tepēr parregullēsī. Nga ana tjetēr, pēr caktim tē statusit juridik tē kētyre objekteve kērkesē ka parashtruar edhe personi i cili gjoja se i ka ndērtuar objektet e lēndēs, ai ka qenē me dhunē i larguar nga ato dhe i ēshtē pamundēsuar tē hyn nē tē njējtēt me qēllim tē pēgaditjes sē elaboratit gjeodezik pēr tē cilēn ka informuar mē tepēr institucione. Si pērfundim nga denoncimi, theksohet se organi kompetent – Komuna e Shuto Orizares nuk ka vepruar nē pērputhje me nenin 9 nga Ligji pēr procedurē me objekte e ndēruar pa leje sepse nuk ka tē vulosur Procesverbal pēr mbikqyrje nē vend-ngjarje, si dhe nē pērputhje me nenin 10 nga ligji i njējtē sepse nuk ka marrē asnjē vendim pēr ndērprerje tē procedurēs.

Me qēllim tē pērcaktimit tē gjendjes faktike pēr lēndēn e hapur, Komisioni shtetēror ka kērkaur nga Inspektorati shtetēror administrativ qē nē kuadēr tē kompetencave tē veta ligjore tē bēnē inspektim tē jashtēzakonshēm nē komunēn e Shuto Orizares nē lidhje me procedurēn pēr pērcaktim tē statusit juridik tē objektit tē ndērtuar pa leje me kērkesē tē vulosur me numēr 09-815/1 me datē 23.05.2011 pēr objekte tē cilēt gjenden nē P.L. 1728/1 K.K. parashtruar nga personi

Pas kērkesēs sē Komisioni shtetēror, Inspektorati shtetēror administrativ dorēzoi informim se ēshtē bērē inspektimi i jashtēzakonshēm me shtojcē dokumentacion dhe vendim pēr inspektim. Duke parē Procesverbalin numēr IP nr. 09-103 me datē 13.02.2020 nē pjesēn pēr vērtetim tē gjendjes ēshtē konstatuar gjendja vijuese kronologjike: ”Me datē 23.05.2011 personi ka parashtruar kērkesē pēr pērcaktim tē statusit juridik tē objektit tē ndērtuar pa leje, vulosur nē komunēs me numēr 09-815/1 me datē 23.05.2011 pēr objekte tē gjenden nē P.K. 1728 K.K. Me kērkesēn janē dorēzuar shtojca, kurse nē lēndēn ka edhe procesverbal nga mbikqyrja e bērē (nr. 09-815/1 me datē 15.09.2011) mirēpo i njējtī nuk ēshtē nēshkruar nga anētarēt e pērmendur tē komisionit. Nē bazē tē shtojcēs sē dorēzuar me kērkesēn dhe procesverbalin e pērmendur, me datē 15.09.2011 ēshtē vulosur Pēlqim urbanistik me numēr 09-815/3. Me datē 06.10.2011 ēshtē vulosur Llogari pēr pagesē tē kompenzimit dhe pērgaditje tē Akt-vendimit pēr vērtetim tē statusit juridik tē objektit tē ndērtuar pa leje. Personi prezent gjatē mbikqyrjes sqaron se mjetet e pērcaktuara me llogaritjen (vlerē prej 1.064.069,00 denarē) janē paguar me datē 05.10.2011 qē tregon faktin se parashtruesi ka qenē gojarisht i lajmēruar pēr lartēsīnē e kompenzimit. Gjithashtu, gjatē mbykqyrjes tregohet se pēr objektit e njējtē (nē P.K. 1728/2 nē K.K.) nē komunē ēshtē dorēzuar kērkesē pēr pērcaktim tē statusit juridik tē objektit tē ndērtuar pa leje, vulosur me numēr 09-4731/1 me datē 01.09.2011 parashtruar nga personi dhe Ndērkohē me kērkesē ēshtē dorēzuar edhe informim (nr.09-473) me tē cilēn parashtruesit e informon komunēn se pēr objektin e njējtē vetēmse ka tē parashtruar kērkesē nga personi, i cili me dhunē ka uzurpuar pronēn e (sipas deklaratēs sē parashtruesit) dhe kērkon qē mos tē legalizohet objekti nē emēr tē (nr. 09-4731 me datē 01.09.2011). Deri nē ditēn e mbikqyrjes nuk ēshtē vendosur pēr kērkesēn pērcaktim tē statusit juridik tē objektit tē ndērtuar pa leje, vulosur me numēr 09-4731 me datē 01.09.2011 parashtruar nga parashtruesit dhe, dhe gjithashtu nuk ēshtē vendosur pēr kērkesēn e tij (nr. 10-328 me datē 27.02.2019) pēr shpallje si tē anuluar Vendimin pēr pērcaktim tē statusit juridik tē objektit tē ndēruar pa leje – objekt afarist me numēr 09-815/5 me datē 06.10.2011.

Në vijim të procesverbalit, inspektorati administrativ thirret në dispozitat e Ligjit për procedurë me objektet e ndërtuara pa leje (Gazeta zyrtare e RM, nr. 23/11 190/17) ku janë të caktuar kushtet, mënyrën dhe procedurën për evidentim, përcaktim të statusit juridik dhe sanksionim të objekteve të ndërtuara pa leje. Në nenin 10 paragrafi 3 nga ligji (në rastin kur janë të parashtruar më tepër kërkesa në kundërshtim mes veti për përcaktim të statusit juridik të një objekti të ndërtuar pa leje, nga ana e më tepër kërkesve, organi kompetent në afat prej 10 ditë nga dita e pranimit të kërkesës merr përfundim për ndërprerje të procedurës, dhe u udhëzon kërkesit në procedurë gjyqësore për gjikatës kompetente) paraparë mënyra e veprimit të organit kompetent, në rastin komuna, nëse bëhet fjalë për objektin e njëjtë për të cilën kërkesë ka parashtruar (nr. 09-815/1 me datë 23.05.2011) dhe dhe (09-47311/1 me datë 01.09.2011).

Në nenin 11 paragrafi 1 nga ligji është caktuar afati (një vitë nga dita e pranimit të kërkesës, gjegjësisht nga dita e vazhdimit të procedurës, nëse e njëjta është ndërprerë) në të cilën organi kompetent (komuna) duhet të vendosë për kërkesën, gjegjësisht të jep pëlqim urbanistik ose të merr vendim me të cilën e rrefuzon kërkesëm. Në rastin konkret, deri në ditën e mbikqyrjes, nuk është marrë akt administrativ konkret (përfundim për ndërprerje, pëlqim urbanistik ose vendim për rrefuzim) në lidhje me kërkesën (09-4731/1 me datë 01.09.2011) parashtruar nga dhe

Nëse kemi parasyshë dispozitat nga neni 22 nga LPONPL (Ligji për procedurë me objekte e ndërtuar pa leje) , ku është e rregullur procedura e ankesës kundër akteve administrative (përfundim ose vendim), gjegjësisht kundër vendimit ose përfundimit të kryetarit të komunës mund të parashtroher ankesë deri tek organi i administratës shtetëror kompetent për kryerje të çështjeve nga fusha e rregullimit të hapsirës, si dhe dispozitave nga neni 27 LPONPL, kur është e rregulluar se mbykqyrje mbi zbatimin e dispozitave nga LPONPL bënë organi i administratës shtetëror kompetent për kryerje të çështjeve nga fusha e rregullimit të hapsirës, qartë është se ligjësia e akteve të miratuar ose veprimeve eventuale të pandërmarra në lidhje me kërkesën parashtruar sipas LPONPL, e kontrollin Ministria e transportit dhe lidhjes. Inspektorati administrativ gjithashtu potencon se nenon 21-b nga LPONPL ku është e rregulluar se aktet administrative (pëlqimi urbanistik dhe vendimi për përcaktim të statusit juridik të objektit pa leje) të cilët janë dhënë në kundërshtim me dispozitat e LPONPL janë të anuluar.

Në procesverbal konstatohet se duke pasë parasyshë dispozitaaat e LPONPL komuna duhet të marrë akte konkrete administrative (përfundim për ndërprerje, pëlqim urbanistik ose vendim për rrefuzim) në lidhje me kërkesën (09-4731/1 me datë 01.09.2011) parashtrua nga dhe, si dhe për kërkesën (10-328 me datë 27/02.2019) për shpallje të anuluar të Vendimit për përcaktim të statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje – objekt afarist me numër 09-815/5 me datë 06.10.2011, ashtu që do ta rishikon procedurën në lidhje me kërkesën (nr. 09-815/1 me datë 23.05.2011) parashtruar nga, dhe nëse vërtetohet se aktet administrative të cilët janë dhënë në kundërshtim me dispozitaaat e LPONPL, të njëjtat t'i anulon, kurse në përputhje me dispozitat e Kapitulli 14 (neni 121-124) nga ligji për procedurë të përgjithshme administrative. Inspektorati administrativ konstaton se për pjesën tjetër të akuzës të shënuara në përgjigjen e kërkesës për mbledhje të të dhënave dhe shënimeve zyrtare (kronologji të rastit për marrje në pronësi, ligjore ose joligjore të tregut t komunës)

përshkak të moskompetencave të Inspektoratit shtetëror administrativ, nuk janë marrë parasyshtë gjatë kryerjes së mbykqyrjes.

Pas kryerjes së inspektimit të jashtëzakonshëm, inspektori shtetërori cili e ka bërë inspektimin, ka marrë Aktvendim IP1 nr. 09-103 me datë 13.02.2020, me të cilën obligohet – Kryetarë i komunë së Shuto Orizares, të ndërmer masa dhe veprime për largim të mangësive të vërtetuara me Procesverbalin IP1 nr. 09-103 me datë 13.02.2020, gjegjësisht të vendosë – të miraton akt administrativ konkret për kërkesën për përcaktim të statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje nr. 09-4731/1 me datë 01.09.2011, parashtruar nga dhe, si dhe për kërkesën për shpallje si të anuluar të Aktvendimit për përcaktim të statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje – objekt afarist me nr.09-815/5 me datë 06.10.2011, parashtruar nga nga Shkupi, kurse vulosur në komunë me nr.10-328 me datë 27.02.2019.

Njëkohësisht me kërkesën për inspektim të jashtëzakonshëm nga Inspektorati shtetëror administrativ, Komisioni shtetëror kërkon nga Komuna e Shuto Orizares të dorëzon informacione detale për procedurën e përcaktimit të statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje me kërkesë të vulosur me numër 09-815/1 me datë 23.05.2011 për objektet të cilët gjenden në P.K. 1728 në K.K. parashtruar nga Në përgjigjen e dorëzuar me shtojcë dokumentacion, nga ana e komunës, me dy tregime kronologjike për ngjarjeve për marrje të pronësisë të tregut në Komunën e Shuto Orizares. Gjithashtu, jepet tregim kronologjik për procedurën për përcaktim të statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje me kërkesë të vulosur me nr. 09-815/1 me datë 23.05.2011 për objektet që gjenden në P.K. 1728/2 në K.K. parashtruar nga, me shtojcë kopje nga dokumentacioni, ku edhe vetë komuna thekson se cilët lëshime janë bërë. Gjithashtu, në përgjigjen theksohet se për objektet e njëjta kërkesa për përcaktim të statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje nr.09-4731/1 me datë 01.09.2011 kan parashtruar dhe, për të cilën procedurë gjithashtu kronologjikisht theksohet dhe është dorëzuar dokumentacion në shtojcë.

Duke pasë parasyshtë të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror përsëri u drejtua deri tek Inspektorati shtetëror administrativ dhe deri në komunën e Shuto Orizares me kërkesë që të informojnë se vallë a është vepruar nga ana e komunës për Aktvendimin e Inspektoratit shtetëror administrativ me numër të arkivës IP1 09-103 me datë 13.02.2020. Nga lajmërimet e dorëzuara nga ana e të dy institucioneve konstatohet se nga ana e Inspektoratit shtetëror administrativ është bërë inspektim kontrollues në komunën e Shuto Orizares dhe duke vepruar për Aktvendimin e miratuar IP1 nr. 10-103 me datë 13.02.2020, komuna miratoi Aktvendim për shpallje si të anuluar Pëlqimin urbanistik (nr.10-365/2 me datë 03.03.2020) dhe Aktvendim për përcaktim të statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje (nr.10-365/3 me datë 03.03.2020). Gjithashtu, gjatë mbikqyrjes kontrolluese janë prezentuar dhe Përfundime për ndërprerje të procedurës për kërkesën për përcaktim të statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje (nr.4731/1 me datë 01.09.2011) parashtruar nga dhe

Duke pasë parasyshtë të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenin 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 12/19), vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР ПЁР
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ
Kryetarё: Biljana Ivanovska

Pas pёrfundimit тё seancёs сё KSHPK
Pёrpunoi: m-r B., K., Sh., Kёshilltarё
Mitaroi: S., P., D., Anёtarё i KSHPK

